Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	**07.12.2023**	**15.12.2023**	**2023/0989**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 07.12.2023, OE "CTA " Sh.p.k."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0989, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Faza e dyte e punimeve ne QTM, te ndara ne tri lote LOT 1 Punimi i ngrohje, ventilimit dhe ujesjellesit LOT 2 Punimi i Dyreve dhe dritrareve LOT 3 Punimet e lyrjes pllakave dhe fasades" me nr. të prokurimit: "635-23-10151-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 613,712.66 € vlera Totale e 3 Loteve. LOT 1 Punimi i ngrohje, ventilimit dhe ujësjellësit Vlera : 344.885.76 Euro, LOT 2 Punimi i Dyreve dhe dritareve Vlera : 79.465.00 Euro, LOT 3 Punimet e lyerjes pllakave dhe fasades Vlera : 189.361.90 Euro.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

A01 Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 43, Ndërprerja e procedurave të prokurimit I A01 Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave sipas A01 Rregullore Nr.001/2022 për
Prokurimin Publik

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne kemi pranuar NJOFTIMIN MBI VENDIMIN E AK (LOT 1 LOT 2 LOT 3) me datë: 13.11.2023, ku ne permes Letrees standarde per tenderuesin e sukseshem jemi shpallur fitues kompania jonë CTA Sh.P.K;

PERMES Letres standarde për tenderuesin e pasuksesshëm me datë: 24.11.2023, jemi njoftuar që ky aktivitet i prokurimit anulohet me arsyeimin: per shkake te gabimeve qe kan ndodhur gjate pergaditjes se SPECIFIKAVE TENDERIT. Gabimet jane te pa riparueshme ne ket faze ,prandaj e vetmja mundesi eshte korigjimi i SPECIFIKAVE TEKNIKE TE TENDERIT dhe te RISHPALLIEN E TENDERIT.

Me datë: 28.11.2023, kemi parashtruar kërkesen për rishqyrtim tek AK, kunder njoftimit për anulim;

Me datë: 30.11.2023, AK: Komuna e Pejës na ka kthyer përgjigje në kërkesën për rishqyrtim, ku ka refuzuar kërkesen tonë.

Me rastin e anulimit Autoriteti kontraktues: KOMUNA E PEJËS ka shkelur rënde dispozitat e LPP-së duke bëre anulimin e procedurës së prokurimit pa bazë logjore dhe duke na dëmtuar ne si kompani fituese në këtë aktivitet.

Anulumi I tenderit nga Autoriteti kontraktues: KOMUNA E PEJËS është në kundershtim me dispozitat ligjore, konkretisht:

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit A01 Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 43, Ndërprerja e procedurave të prokurimit I A01 Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik 43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave sipas A01 Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

Sepse ne jemi dëmtuar si kompani fituese, sespe ne nuk jemi trajtuar në menyrë të barabartë, dhe duke u pasur parasysh: Neni 62 të LPP-së Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit 1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Pra pasi është bërë hapja e tenderve duke ju referuar Neni 62 të LPP-së, pika 1, 1.1, 2, 2.1, asnjë nga këto pika nuk plotësohen për anulimin e procedures së prokurimit pas hapjes së tendereve, gjë që ky veprim për anulim na dëmton neve si kompani fituese që ka ofertuar cmimin ekonomikisht me të favorshem dhe autoriteti kontraktues shkelë në menyrë flagrante dispozitat e LPP-së.

Me rastin e anulimit të ketijë aktiviteti. Autoriteti kontraktues ka shkelur edhe A01 Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, nenin 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit, 43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave, ku është e specifikuar qartë që një procedurë e prokurimit mund të anulohete vëtëm nese plotësohen këto kushte:
43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm; RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK 81
c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një

OE është më pak se 3(tre);
d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
g. asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm; h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose
k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

Pra pasi është bërë hapja e tenderve duke ju referuar A01 Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, nenin 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit, 43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave, asnjë nga këto pika nuk plotësohen për anulimin e procedurës së prokurimit pas hapjës së tendereve, gjë që ky veprim për anulim na dëmton neve si kompani fituese që ka ofertuar cmimin ekonomikisht me të favorshem, në këtë rast Autoriteti kontraktues përseri bënë shkeljen e dispozitave ligjore.

Me datë: 30.11.2023, AK: Komuna e Pejës na ka kthyer përgjigje në kërkesën për rishqyrtim, ku ka refuzuar kërkesen tonë.

Ndër arsyet e anulimit është specifikuar:

Ju njoftojm se pretendimet e juaj ankimore jan te pa bazuara pasi qe ne si A.K kemi vepruar konform LPP-se, pasi qe ka ndodhur nje gabim teknik te paramasa parallogaria pozicioni **A. 6 Shkuma per fiksim me montim** te Sasia nuk eshte vendosur fare vlera dhe eshte nje gabim i pa riparushem ne ket proces po ashtu edhe ju ne oferten e juaj te dorzuar me daten 01.11.2023 tek paramasa parallogaria tek ky pozicion te njesia Cmimi me TVSH kendi vendorus cmimin ndersa te vlera totale nuk keni vendosur fare cmim qe eshte ne kundershtim me LPP-ne

KOMUNA E PEJES

LOT 1

1	BANESAT E SOCIALIT E REJA - PEJE

Punët për çdo pozicion duhet të përfshijrë blerjen, transportin, montimin, lidhjet, shpërndarjen ne dysheme, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin dhe lëshimin e atestimeve. Në punë duhet të kalkulohet edhe materiali i imët. Para dhënies së ofertës patjetër të lexohet përshkrimi teknik dhe të shiqohen projektet.

Fozic. A	Tubacioni				
A.	*Emertimi i materialit*	Njesia	Sasia	Cmimi me TVSH	Vlera
A. 1	Furnizimi dhe montimi i tubacionit per dysheme me karakteristika: PE-RT Φ17x2mm oksigjen barier, pesë shresor, ngjyra e kuce, prodhuar sipas standarceve EN ISO 21003	m	3600	1,00 €	3,600.00 €
A. 2	Kapse per fiksim te gypit nga plastika me montim	cope	5000	0.03 €	150.00 €
A. 3	Foli alumini per dysheme me montim	m2	580	0.65 €	377.00 €
A. 4	Njjiles zolir nga aluminit per foli me montim	Cope	12	2.00 €	24.00 €
A. 5	Furnizimi dhe montimi i kaseta metalike 450mmX 800mm	cope	6	55.00 €	330.00 €
A. 6	Shkuma per fiksim me montim	cope		4.00 €	0.00 €
A. 7	Furnizimi dhe montimi i gypave te furnizimit ne kaseta shoerndaresa: Gypi aluplast 32x3mm me izolim	m	178	4.50 €	801.00 €

Andaj ne si A.K ju njoftojm se pretendimet e juaja ankimore jane te pa bazuara, dhe ne kemi vepruar konform LPP-se dhe Rregullave.

Kompania jonë me rastin e ofertimit ka vërejtur që në paramasa parallogaria pozicioni A. 6 Shkuma per fiksim me montim te Sasia nuk eshte vendosur fare Sasia (sa copë) nevoiten, prandaj ne kemi vendosur vetem cmimin për njësi, ndërsa tek Vlera totale nuk kemi vendosur cmim për arsye që sasi nuk ka qenëe vendosur nga AK dhe ne e kemi pasur te pamundur të vendosim Vleren totale tek ky pozicion, Pra gabimi qendron tek AK, që nuk kanë vendosur sasinë tek pozicioni A.6.

AK duke u thirrur në gabimin teknik që nuk kan vendosur sasinë te paramasa parallogaria pozicioni A. 6 Shkuma per fiksim me montim, nuk mund ta bëjë anulimin e procedurës me këtë arsyetim, sepse shkel rëndë dispozitat e LPP-së, ku në nenin:

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit;

A01 Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik; Neni 43, Ndërprerja e procedurave të prokurimit I A01 Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik 43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së

ofertave sipas A01 Rregullore Nr.001/2022 për

Prokurimin Publik, është shumë e qartësuar se kur mund të aulohet një aktivitet i prokurimit pas hapjes së ofertave dhe shpalljes së fituesit.

Poshtu duke u nisur nga fakti që ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me ekzekutimin e punimeve, LPP ja mundëson AK, që nese nuk ka paraparë sasinë siç duhet, ti shtoj sasitë përmës Aneks Kontratës deri në 10% të vlerës totale të kontratës, në rastin tonë: Te paramasa parallogaria pozicioni A. 6Shkuma për fiksim me montim, bazuar në çmimet e tregut që një shkumë për fiksim me montim kushton 4.00€, AK e ka shumë të lehtë që kët gabim teknik të tyre ta përmiresoj duke u bazuar në dispoziat ligjore.

Prandaj kërkojm nga OSHP që të bëjë anulimin e njoftimit per anulimin e ketij Aktiviteti, të Urdhëroj Autotritetin Kontraktues: Komuna e Pejës, të vazhdoj me proceduren e prokurimi, dhe ne si Kompani që kemi oferuar çmimin ekonomikisht më të favorshem dhe jemi të përgjegjshëm, të shpallemi fitues në këtë aktivitet dhe të shperblehemi me kontratë.

KRITERET PËR VLERËSIM

LOT 1

1	BANESAT E SOCIALIT E REJA - PEJE

Punët për çdo pozicion duhet të përfshijnë blerjen, transportin, montimin, lidhjet, shperndarjen ne dysheme, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin dhe lëshimin e atestimeve. Në punë duhet të kalkulohet edhe materiali i imët. Para dhënies së ofertës patjetër të lexohet përshkrimi teknik dhe të shiqohen projektet.

Pozic. A Tubacioni

A .	*Emertimi i materialit*	Njesia	Sasia	Cmimi me TVSH	Vlera
A. 1	Furnizimi dhe montimi i tubacionit per dysheme me karakteristika: PE-RT Φ17x2mm oksigjen barrier, pesë shtresor, ngjyra e kuqe, prodhurar sipas standardeve EN ISO 21003	m	3600	0.00 €	0.00 €
A. 2	Kapse per fiksim te gypit nga plastika me montim	cope	5000	0.00 €	0.00 €
A. 3	Foli alumini per dysheme me montim	m2	580	0.00 €	0.00 €
A. 4	Ngjites izolir nga aluminit per foli me montim	Cope	12	0.00 €	0.00 €
A. 5	Furnizimi dhe montimi I kaseta metalike 450mmX 800mm	cope	6	0.00 €	0.00 €
A. 6	Shkuma per fiksim me montim	cope		0.00 €	0.00 €
A. 7	Furnizimi dhe montimi i gypave te furnizimit ne kaseta shperndarese: Gyp aluplast 32x3mm me termoizolim	m	178	0.00 €	0.00 €
A. 8	Pjesëlidhese pres per aluplast: Gjysemlidhese fi 32-1" FJ me montim	cope	36	0.00 €	0.00 €
A. 9	Pjesëlidhese pres per aluplast: Kthesa fi 32-1" 90° me montim	cope	60	0.00 €	0.00 €
A. 10	Furnizimi dhe montimi i kolektor te dyshemes me 9+9 dalje, trupi 5/4", dalja per lidhese 3/4", prodhime EU	par	3	0.00 €	0.00 €
	Furnizimi dhe montimi i kolektor te dyshemes me 7+7 dalje, trupi 5/4", dalja per lidhese 3/4", prodhime EU	par	3	0.00 €	0.00 €
A. 11	Furnizmi dhe montimi i gjysem lidhese per kolektor 17x2mm,	cope	84	0.00 €	0.00 €
A. 12	Furnizimi dhe montimi i valvules me holander G1"	cope	12	0.00 €	0.00 €
A. 13	Duplinipli 1" mesing me montim	cope	24	0.00 €	0.00 €
A. 14	Furnizimi dhe montimi i lakesave te plastikes per tub te dyshemes	cope	84	0.00 €	0.00 €
A. 15	Furnzimi dhe montimi i shine mbajtese per gyp te dyshemes nga plastika	m	1500	0.00 €	0.00 €

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E PROKURIMIT
KOMUNA E PEJËS

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: : Faza e dyte e punimeve ne QTM, te ndara ne tri lote
LOT 1 Punimi i ngrohje, ventilimit dhe ujesjellesit RIVLERSIM

Nr. i prokurimit [1]	**635-23-10151-5-1-1**
Nr i brendshëm	**635-23-091-511**

Radhë	Lënda / grupi: LOT 1 Punimi i ngrohje, ventilimit dhe ujesjellesit RIVLERSIM	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	" CTA " Sh.p.k., 600028816	199,907.08
2.	" EJONA " SH.P.K., 810089913	204,444.45
3.	URANIKU-SG SH.P.K, 600445226	230,988.57

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

KOMUNA E PEJES ANULON

Ky A.P Anulohet per shkake te gabimeve qe kan ndodhur gjate pergaditjes se SPECIFIKAVE TENDERIT . Gabimet jane te pa riparueshme ne ket faze ,prandaj e vetmja mundesi eshte korigjimi i SPECIFIKAVE TEKNIKE TE TENDERIT nga Njsia Kerkuese dhe RISHPALLIEN E TENDERIT me procedura te pershpejtuara siq e parasheh LPP-ja .

Data: **24.11.2023**

Milot Gashi
Menaxher i Prokurimit

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" CTA " Sh.p.k.**

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejës, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës punë. Vlera e parashikuar e kontratës 613,712.66 Euro Vlera Totale e 3 Loteve.

LOT 1 Punimi i ngrohje, ventilimit dhe ujësjellësit Vlera : 344.885.76 Euro,

LOT 2 Punimi i Dyreve dhe dritareve Vlera : 79.465.00 Euro

LOT 3 Punimet e lyerjes pllakave dhe fasades Vlera : 189.361.90 Euro

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit përkatësisht kundër anulimit "***LOT 1 Punimi i ngrohje, ventilimit dhe ujësjellësit"*** pas publikimit të B58 Njoftimit mbi vendimin e autoriteti kontraktues.

Operatori ekonomik ankues "CTA" Sh.p.k pretendon se AK në kundërshtim me nenin 62 të Lpp-së, dhe nenin 43 të paragrafi 5 të Rregullores nr.001/2022, ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me këto dispozita, po ashtu ankuesi potencon se ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me ekzekutimin e punimeve, LPP ja mundëson AK që nëse nuk ka paraparë sasinë, duhet ti shtoj sasitë përmes Aneks kontratës deri në 10% të vlerës totale të kontratës. Te paramasa parallogaria pozicioni A .6 Shkuma për fiksim me montim kushton katër (4) euro, AK e ka shumë të letë qe këtë gabim teknik te tyre ta përmirësoj duke u bazuar ne dispozitat ligjore

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik ankues, pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 60 dhe 62 të LPP-së dhe neni 43. par 5 të Rregullores nr.001/2022.

Ekspertja shqyrtuese fillimisht sqaron se AK përmes formularit B58 Njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues Komuna e Pejës me dt:13.11.2023, ka rekomanduar për kontratë për '***LOT 1 Punimi i ngrohje, ventilimit dhe ujësjellësit*"** operatorin ekonomik ankues "CTA" Sh.p.k (ankues). Pas publikimet të këtij njoftimi, operatori ekonomik "Ejona" sh.p.k parashtron kërkesë për rishqyrtim me datë 20.11.2023, me pretendimin se OE i rekomanduar

për kontratë ka ofruar çmimin zero për artikullin/pozicioni A.6 –Banesat sociale e reja, dhe çmimi zero në paramase është i ndaluar sipas LPP-së dhe nuk lejohet vlera zero në paramase. AK-Komuna e Pejës aprovon si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim te operatori ekonomik "Ejona" sh.p.k dhe lenden e rikthen në rivlerësim. Pas rivlerësimit, AK me datën 24.11.2023 anulon aktivitetin e prokurimit, përkatësisht Lot 1, me arsyetimin se:

"Ky aktivitet i prokurimit anulohet për shkak të gabimeve që kanë ndodhë gjatë përgatitjes se specifikave tenderit gabimet janë të pa riparueshme në ketë fazë, prandaj e vetmja mundësi është korrigjimi i specifikave teknike te tenderit nga njësia kërkues dhe ri shpalljen e tenderit me procedura të përshpejtuar siç e parasheh LPP-ja"

Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës, pretendimet e ankuesit dhe arsyetimin e anulimit të aktivitetit të prokurimit, vlerëson se gabimet të cilat kanë ndodhë në paramasë dhe parallogari nuk munden në ketë fazë të evitohen / përmirësohen. Po ashtu, edhe OE ankues potencon në ankesë se "Kompania jonë me rastin e ofertimit **ka vërejtur** që në paramasa parallogarit pozicioni A.6 Shkuma për fiksim me montim **te sasia nuk është vendosur fare sasia (sa copë) nevojiten** , prandaj ne kemi vendosur vetëm çmimin për njësi ndërsa tek vlera totale nuk kemi vendosur çmimin për arsye që sasia nuk ka qenë vendosur nga AK dhe ne kemi pasur të pa mundur te vendosim vlerën totale tek ky pozicion, **para gabimi qëndron tek AK që nuk** kanë vendosur sasinë tek pozicioni A.6.". Meqenëse, OE ankues e potencon që e "ka vërejtur" se pozicioni A6 nuk është vendosur sasia, ka mundur që të bëjë kërkesë për sqarime të tenderit me qëllim të përmirësimit të paramasës lidhur me pozicionin A6 të paramasës dhe të mos vjen deri të anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit. Andaj, në këtë fazë nuk mund të përmirësohet ky gabim në paramasë, ndërsa vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është i pamundur të bëhet konform nenit 59 të LPP, dhe për këtë arsye **ekspertja konsideron** se duhet të vërtetohet vendimi i AK-së për anulim të kësaj procedure.

Provë: ParamasA dhe parallogarinë "3.Banesat e sociale e reja-Peje"

LOT 1

1	BANESAT E SOCIALIT E REJA - PEJE

Punët për çdo pozicion duhet të përfshijnë blerjen, transportin, montimin, lidhjet, shperndarjen ne dysheme, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin dhe lëshimin e atestimeve. Në punë duhet të kalkulohet edhe materiali i imët. Para dhënies së ofertës patjetër të lexohet përshkrimi teknik dhe të shiqohen projektet.

Pozic. A	Tubacioni				
A .	*Emertimi i materialit*	Njesia	Sasia	Cmimi me TVSH	Vlera
A. 1	Furnizimi dhe montimi i tubacionit per dysheme me karakteristika: PE-RT Φ17x2mm oksigjen barrier, pesë shtresor, ngjyra e kuqe, prodhurar sipas standardeve EN ISO 21003	m	3600	0.00 €	0.00 €
A. 2	Kapse per fiksim te gypit nga plastika me montim	cope	5000	0.00 €	0.00 €
A. 3	Foli alumini per dysheme me montim	m2	580	0.00 €	0.00 €
A. 4	Ngjites izolir nga aluminit per foli me montim	Cope	12	0.00 €	0.00 €
A. 5	Furnizimi dhe montimi I kaseta metalike 450mmX 800mm	cope	6	0.00 €	0.00 €
A. 6	Shkuma per fiksim me montim	cope		0.00 €	0.00 €
A. 7	Furnizimi dhe montimi i gypave te furnizimit ne kaseta shperndarese: Gyp aluplast 32x3mm me termoizolim	m	178	0.00 €	0.00 €
A. 8	Pjesëlidhese pres per aluplast: Gjysemlidhese fi 32-1" FJ me montim	cope	36	0.00 €	0.00 €
A. 9	Pjesëlidhese pres per aluplast: Kthesa fi 32-1" 90* me montim	cope	60	0.00 €	0.00 €
A. 10	Furnizimi dhe montimi i kolektor te dyshemes me 9+9 dalje, trupi 5/4", dalja per lidhese 3/4", prodhime EU	par	3	0.00 €	0.00 €
	Furnizimi dhe montimi i kolektor te dyshemes me 7+7 dalje, trupi 5/4", dalja per lidhese 3/4", prodhime EU	par	3	0.00 €	0.00 €
A. 11	Furnizmi dhe montimi i gjysem lidhese per kolektor 17x2mm,	cope	84	0.00 €	0.00 €
A. 12	Furnizimi dhe montimi i valvules me holander G1"	cope	12	0.00 €	0.00 €
A. 13	Duplinipli 1" mesing me montim	cope	24	0.00 €	0.00 €
A. 14	Furnizimi dhe montimi i lakesave te plastikes per tub te dyshemes	cope	84	0.00 €	0.00 €
A. 15	Furnzimi dhe montimi i shine mbajtese per gyp te dyshemes nga plastika	m	1500	0.00 €	0.00 €

Prandaj në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, sqarimeve dhe provave të bashkangjitura si më lartë, ekspertja shqyrtuese propozon që të vërtetohet vendimi i AK-së që ky aktivitet i prokurimit anulohet për shkak të gabimeve tek paramasa dhe parallogaria e autoritetit kontraktues, ankesa e operatorit ekonomik ankues të refuzohet si e pabazuar. Ndërsa autoriteti kontraktues gjatë ri shpalljes të këtij aktivitetit të prokurimit të ketë parasysh nenin 17.12, i Rregullores Nr.001_2022 për prokurimin publik, përcakton: “...Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë..”

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK mbi anulimin e aktiviteti të prokurimt..

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" CTA " Sh.p.k.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Majlinda Bedrolli